

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTI TE  
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER**

**NDERTIMIN:**

"IMPJANT PER NDARJEN E XEHERORIT TE BAKRIT  
PLUHUR SIPAS KAPACITETEVE TE TYRE RELATIVE PER  
PLUSKIM NE LENG DHE PAKESIMIN E SUBSTANCAVE  
STERILE"

(FABRIKE PASURIMI MINERALI TE BAKRIT DHE  
VENDEPOZITIM I MASES STERILE)

**Vendodhja :** Fshati Gurth-Spac, Njesia  
Administrative Orosh, Bashkia Mirdite,  
Qarku Lezhe.

**Kërkues:** Subjekti: "TETE ALBANIA TUNNEL  
& MINING "shpk

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k


Administrator

Elidiana Shehu




Altin Ahmeti

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014 )



Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



Janar, 2017

---

## Tabela e Permbajtjes

|      |  |           |
|------|--|-----------|
| 1.   | Te pergjithshme, pershkrim i shkurter i projektit te propozuar .....               | 2         |
| 1.1. | Qellimi i Projektit te Propozuar .....   | 2         |
| 1.2. | Projekti i Propozuar .....   | 2         |
| 1.3. | Studimi i Raportit te VNM-se .....   | 2         |
| 2.   | Pershkrimi i kuadrit ligjore dhe institucional .....                               | 4         |
| 2.1. | Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis .....                                   | 4         |
| 2.2. | Kuadri ligjor kombetar .....   | 5         |
| 2.3. | Permbledhje e kuadrit ligjor .....   | 6         |
| 2.4. | Metodologjia e Vleresimit .....  | 7         |
| 3.   | PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....   | 8         |
| 3.1. | Vendndodhja e Projektit .....  | 8         |
| 3.2. | Te dhena te pergjithshme te Projektit .....  | 9         |
| 4.   | IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS .....                            | 11        |
| 4.1. | Ndikimi ne cilesine e sasine e tokes bujqesore .....                               | 11        |
| 4.2. | Ndikimi ne perdorim te burimeve .....  | 11        |
| 4.3. | Ndikime ne modelin drenazhues te zones .....                                       | 11        |
| 4.4. | Ndryshimet e karakteristikave te tjera hidrografike .....                          | 11        |
| 4.5. | Ndikimet ne ajer dhe ne klime .....  | 12        |
|      | <i>Niveli dhe perqendrimi i emetimve kimike dhe ndikimet e tyre mjedisore ....</i> | <i>12</i> |
| 5.   | Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative .....              | 13        |
| 5.1. | Identifikimi i masave per te zbutur ndikimet negative ne mjedis .....              | 13        |
| 6.   | VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT .....                | 15        |
| 6.1. | Te pergjithshme per Bashkine Mirdite .....   | 15        |

# **1. Te pergjithshme, pershkrim i shkurter i projektit te propozuar**

## **1.1. Qellimi i Projektit te Propozuar**

Qëllimi i projektit është ndertimi i **“Impianti për ndarjen e Xeherorit të Bakrit Pluhur sipas kapaciteteve të tyre relative për pluskim në lëng dhe pakesimin e substancave sterile “ ose e thene ndyshe (Fabrike pasurimi minerali bakrit dhe vendepozitim i masës sterile)** me vendodhje në fshat Gurth -Spac , Njesia administrative Orosh, Bashkia Mirdite , Qarku Lezhe nga subjekti TETE ALBANIA TUNEL & MINING shpk.

## **1.2. Projekti i Propozuar**

Ky projekt teknologjik i fabrikes se re te pasurimit te bakrit Spac mbështetet në studimin e pasurimit dhe në projektin teknologjik të pasurimit të mineralit të bakrit të minierës Spaç, Mirdite, të kryer nga specialistet Kineze, të cilët në vitin 1972 kanë ndertuar fabrikën e parë të pasurimit të mineralit të bakrit në Reps me teknologji kineze. Mbështetet gjithashtu edhe në eksperiencën 37 vjeçare të punës në fabrikën e Repsit.

Fabrika e pasurimit të bakrit në Reps ka filluar punë në vitin 1972 dhe është mbyllur në vitin 1997 për shkak të konjunkturave të tregut.

Projekti do të realizojë pasurimin e mineralit të bakrit të vendburimit Spac, që shfrytëzohet nga po kjo kompani, duke arritur të prodhojë koncentrat bakri çilesor për nevojë të tregut të industrisë perpunuese të bakrit.

Kompania TETE ALBANIA TUNEL & MINING shpk është e pajisur me leje shfrytëzimi edhe për minierën nëntokesore të zonës Minerare nr.1068 aktivitet i cili është trajtuar me leje të vecanta .

Bazuar në rezervat minerare, të kësaj miniere dhe kondicionin ekonornik, në projekt janë zgjedhur edhe trupat minerare me kushte të favorshme, me përmbajtje të bakrit në xeheror, të pranueshme për një prodhim konkurrues.

Theksojmë se me këto të dhëna e sipas natyrës mineralogjike të vendburimit fabrika e pasurimit arrin jo vetëm tregues optimale tekniko-ekonomike por edhe një regjim të mirë në drejtim të shkarkimeve në mjedis

## **1.3. Studimi i Raportit të VNM-se**

Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e mjedisit ku do të shfrytëzohet për germimin dhe nxjerrjen e mineralit, përfshirë kushtet fizike, të burimeve ujore, biologjike, atmosferike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese të përfituara rishtas mbi kushtet e mjedisit të sheshit që do të shfrytëzohet, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të faciliteve të propozuara.

## Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuara në procesin e VNM përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, cilesinë e ajrit, tokës, mjedisit biologjik dhe situatën social-ekonomike dhe kulturore. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të shfrytëzimit të burimit, rehabilitimit dhe monitorimit.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të kërkuar.

Korniza kryesore e kuadrit ligjor për përgatitjen e këtij Raporti të përmbledhur të VNM:

- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Metodologjia e hartimit të këtij raporti të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Vendimit të KM Nr. 13, datë 04.01.2013 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

### Metoda e përgatitjes së VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-së u bazua në:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Shqipëri për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit;
- Vlerësimin e përputhshmerisë së parimeve baze të rregullave shqiptare duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t'i zgjidhur ato;
- Përgatitjen e udhëzimeve për identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë përgatitjen e kriterëve seleksionues socialë dhe mjedisore për të përzgjedhur projektet për implementimin dhe për të përcaktuar nivelin e studimeve/vlerësimeve sociale dhe mjedisore që kërkohen;
- Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese të nenprojektit në lidhje me zonën ku po ekzekutohet ky i fundit.

Institucionet përgjegjëse kanë në organiken e tyre një sërë inspektorësh dhe teknikësh si në nivelin qendror ashtu dhe në atë rajonal, si dhe një specialist të mjedisit, që do të jetë përgjegjës për monitorimin e këtij studimi dhe të vlerësimeve të tjera mjedisore specifike si dhe do të trajtojë njesitë e qeverisjes vendore për t'iu përmbajtur kërkesave të parashtruara në Leje Mjedisore.

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik te disponueshem, juridik e projekt-shfrytezimin.

## **2. Pershkrimi i kuadrit ligjore dhe institucional**

### **2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet

ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, paisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

## **2.2. Kuadri ligjor kombetar**

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 ,ky projekt klasifikohet ne listen e aktiviteteve qe duhet te pajisen me leje mjedisore .

Sipas Ligjit Nr. 10440, date 07.04.2011 "Per VNM", shtojca 1 dhe VKM. Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për Miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se VNM-se dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore", ky projekt duhet ti nenshtrohet procedures se miratimit te VNM se Paraprake

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM paraprake. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

### 2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”
- Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”
- Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për Miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se VNM-se dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore”
- Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.
- Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”

Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

- Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventes se Aarhusit” Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tiu drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.
- Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).
- Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor”.
- Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit” Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.
- Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve”

## 2.4. Metodologjia e Vleresimit

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik, inxhinierik dhe juridik. Ky projekt pergatitet me kerkese te investitorit, subjekti “TETE ALBANIA TUNNEL & MINING ” Sh.p.k, si dhe jane kryer inspektive ne terren per identifikimin e elementeve mjedisore dhe te biodiversitetit.

Ministria e Mjedisit eshte autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuat dokumentacionin VNM, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit Paraprake te VNM-se:

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se


| Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar  | Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)  |
|--|---|
| Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”                          | Sipas kerkesave te ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, Shtojca 1 per Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet per paisje me leje mjedisore.                           |
| Shtojca 1 dhe 2, Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pergatitja e procedures se raportit te permbledhur te VNM-se, sipas klasifikimit ne shtojcen Nr. 2</li> <li>• Organizimi i konsultimit me publikun, sipas VKM</li> </ul> |



### 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

#### 3.1. Vendndodhja e Projektit

Zona e projektit ndodhet ne pjesen veriore te shqiperise , fshati Gurth- Spac , Njesia administrative Oroshe , Bashkia Mirdite , Qarku Lezhe vetem 80 km larg Kryeqytetit te Tiranës .Lartesia mbi detin e zones se projektit eshte 700-950 m .



*Pozicioni I vendodhjes ne harte topografike*

*Koordinatat ne sistemin Gauss- Kruger te Sheshdepozitimit te sterililit.*

| Nr | X            | Y            |
|----|--------------|--------------|
| 1  | 4420971,5844 | 4641592,6212 |
| 2  | 4421079,6730 | 4641459,6450 |
| 3  | 4421568,7683 | 4641800,6144 |
| 4  | 4421399,0758 | 4642042,5094 |
| 5  | 4421532,1834 | 4641968,0133 |
| 6  | 4421502,9570 | 4641880,4275 |

*Koordinatat ne sistemin Gauss- Kruger te Fabrikes se pasurimit*

| Nr | X            | Y            |
|----|--------------|--------------|
| 1  | 4421030,8131 | 4641345,8083 |
| 2  | 4421214,5533 | 4641367,3610 |
| 3  | 4421355,2220 | 4641153,3757 |
| 4  | 4421171,4996 | 4641131,6713 |

## 3.2. Te dhena te pergjithshme te Projektit

### -Venddepozitimi i mineralit

-Platforma prej betoni e konstruksione metalike e mbuleses te thjeshte llamarine te valezuar ne te cilen instalohet linja e plote e pasurimit.

-Stacion elektrik

-Ndertese dy kateshe (parafabrikat), per zyra te personelit, objekte socila kulturore, si fjetore, mjedise higjeno-sanitare etj.

-Ndertese me konstruksione metalike per oficine per sherbim operativ te mjeteve apo makineri paisjeve te tjera si dhe vendqendrimi te tyre.

-Shesh per depo te produktit te gatshem, qe do te jete koncentrat bakri i amballazhuar ne thase , ose me kamion rifuxho.

-Shesh depozitimi te mases sterile qe del gjate procesit teknologjik ( dambe ) .

Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit Punimet e ndertimit dhe te tjera per fabriken e pasurimit jane si me poshte:

- Proceset ndertimore
- Germime dhe mbushje dheu

Per krijimin aksesit dhe terrenit te nevojshem per ndertimin e projektit do te kete germim dhe mbushje te terrenit deri ne arritjen e kuotave te pershtatshme per zhvillimin e objektit. Per hedhjen e materialit te dale nga germimet per fabriken dhe rruget e sherbimit do te perdoret nje siperfaqe rreth 3000m2 ne zonen II minerare.

- Sistemime dhe infrastrukture sherbimi

Pjesa rrethuese e objektit do te jete e sistemuar me skarpata natyrale dhe me shume pak mure mbajtes ose prites. Ne rastet e rrugeve te aksesit do te kete mure dhe ne krijimin e disniveleve te medha te nevojshem per fabriken do te perdoren mure mbajtes. Gjithashtu do te realizohen punime ne infrastrukture ujore mbi dhe nentokesore per furnizim dhe trajtim-largim ujrash te zeza dhe te shiut.

- Punime betoni dhe beton te armuar

Realizimi I shtresave mbeshtetese, bazamenteve, themeleve, mureve mbajtes ose prites do te realizohen me beton dhe beton te armuar. Volume e betonit, te hekurit si dhe rezistenca e betonit per secilen structure do te percaktohet nga rezultatet e llogaritjeve statike te strukturave bazur ne kushtet Shqiptare te projektimit.

- Punime strukture metalike

Fabrika e pasurimit eshte aktivitet me kerkese hapsire te paster dhe te mbuluar te madhe ndaj struktura metalike eshte structure e pershtatshme per realizim e ketij objekti.

Pas llogaritjeve te kryera do te percaktohen saktesisht dimensionimi I konstuksionit metalik dhe volume perkatese bazur ne kushtet Shqiptare te projektimit.

Per realizimin e projektiti do te perdoret rruga egzistuese qe lidh Repsin me Spaçin. Kjo rruge eshte ndertuar per minieren e bakrit Spaç dhe minieren e piritit qe ndodhet ne zonen II Minerare. Ne projekt jane parashikuar rruget e brendeshme automobilistike, te cilat lidhin sheshin e lendes se pare me hyrjen e fabrikes dhe lidhin repartet kryesore dhe ndihmese me njeri tjetrin. Keto jane rruge aksesit gjithashtu do te shfrytezohet edhe rruga egzistuese . Eshte parashikuar gjithashtu dhe rehabilitimi i rrugeve egzistuese.



*Ortofoto e pasqyrimit te akseve rrugore ne ndihme te aktivitetit*

## **4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS**

### **4.1. Ndikimi ne cilesine e sasine e tokes bujqesore**

Siperfaqja e vene ne dispozicion per kete objekt eshte toke ne terren kodrinor—malor te thyer, tip rrepishte e cila nuk paraqet ndonje interes te vecante praktik per veprimtari te tjera.

Siperfaqja e tokes qe do shrytezohet vetem per fabriken e pasurimit , nuk eshte toke bujqesore, nuk ka konflikt pronesie, sepse eshte prone shteterore.

Subjekti ka lidhur kontrate qiraje me Bashkine Mirdite per siperfaqen ku do te ndertohet fabrika e pasurimit te bakrit dhe dampa e sterileve te tij, me nr 5959 Prot, Rreshen me date 07.11.2016.

Si e tille, do te trajtohet sipas legjislacionit nga strukturat e administrates pyjore e pushtetit lokal njekohesisht perdorimi i saj nuk ndikon ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore ne zonen e Spacit.

### **4.2. Ndikimi ne perdorim te burimeve**

Objekti nuk ka ndikime ne burime te tjera te zones si puse uji apo burime ujore te cilat sherbejne si tribunare per perroin object projekti.

### **4.3. Ndikime ne modelin drenazhues te zones.**

Projekti nuk do te kete ndikime ne modelin drenazhues te tokes pasi nuk prek sisteme te tilla dhe eshte larg zonave te populluara e tokes bujqesore ne perdorim.

Theksojme se projekti merr ne konsiderate nje sistemimin e ujrave siperfaqesore te nje perroi(bashkim I dy perroskave) me ane te pritave prej guri dhe orientim te ujrave me dy degezime kanali betoni, duke evituar fenomenin e erozionit te vete zones perreth por edhe te vendepozitimit te mases sterile.

### **4.4. Ndryshimet e karakteristikave te tjera hidrografike**

Ushtrimi i ketj aktiviteti ne kushte normale e ne zbatim te projektit te shfrytezimit nuk do te ndikojne ne nivelin e ujrave, ne rruget ujore dhe ne rrjedhjen e ujrave nentoksore.

Ne kete zone aktiviteti ne afersi te saj nuk ka hurime uji nentoksore apo pus shpime te karakterit hidrogjeologjik per uje te pishem.

Ndikimet e ndotesve, mbetjeve etj ne cilesine e ujit.

Veprimtaria e objektit nuk ka ndikim ne cilesine e ujit, sepse si shkarkimet me ujin, depozitimet ne toke apo shkarkimet ne ajer, nuk kane permbajtje te lendeve te rrezikshme te cilet mund te ndikojne ne ndotjen e ujit.

Mundesia per nje ndotje te ujit te lumit eshte nese nuk zbatohen parametrat e depozitimit ne vendin e ndertuar per kete qellim dhe ato te procesit teknologjik.

Cilesia e ujrave te shkarkimit direkt ne lumin Fan, pas dekantimit te mases sterile ne sheshin e depozitimit, sipas te dhenave te studimit paraprak e te paraqitura ne projektin teknologjik nuk do te kete ndikim ne mjedisin uJOR siperfaqesor dhe nentokesor

#### **4.5. Ndikimet ne ajer dhe ne klime**

##### ***Niveli dhe perqendrimi i emetimve kimike dhe ndikimet e tyre mjedisore***

Ne veprimtarine e punes te ketij objekti nuk ka emetime kimike, me ndikim ne ajer dhe klime.

##### ***Lende te vecanta***

Gjate punes ne kete fabrike nuk ka perdorime te lendeve te vecanta qe te ndikojne ne ndotjen e mjedisit perreth, pervec reagenteve qe theksuam me lart ku kerkohet te permiresohet ventilimi ne mjediset e punes, por sasia e tyre eshte minimale e nuk kane ndikim ne ajrin perreth territorit te ketij objekti.

##### ***Aromat sulmuese***

Gjate punes ne fabrike do te monitorohet e te parandalohet efekti i aromave te ndryshme te cilit lloj qofshin ato.

##### ***Ndikime te tjera klimatike***

Nuk priten ndryshime klimatike si ne permiresim apo keqesim, pasi natyra e punes eshte e tille qe nuk ka ndikime ne ndryshimin e kushteve klimatike.

## 5. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative

### 5.1. Identifikimi i masave per te zbutur ndikimet negative ne mjedis

#### a- Planifikimi i zones

Nje nder elementet qe duhet mbajtur parasysh ne punen ne fabrike eshte evitimi i demtimit te bimesise dhe erozioni per siperfaqen e tokes, per te cilin projekti parashikon shfrytezim harmonik te kombinuar, te zones ku instalohet fabrika dhe depozitohet masa sterile.

Siperfaqja e tokes qe perdoret eshte formacion i qendrueshem, e zgjedhur per objekte te kesaj natyre, sepse deri tani nuk ka te dhena per fenomene te rreshqitjeve apo erozion te zones perreth.

#### b- Masat teknike

Per permiresimet gjeoambientale ne zonen e planifikuar per shfrytezim do te merren keto masa:

- Zbatim rigoroz i projektit e ne vecanti procedura e ndertimit dhe instalimit, per te krijuar kushtet per shfrytezim optimal te siperfaqes.
- Sistemim ne vende sipas rregullave mjedisore te materialeve te ndertimit ashtu edhe lendes se pare ndihmese (si reagente kimike etj ) dhe produktit te gatshem, per te evituar perhapjen kaotike te tyre.
- Kontroll e mirembajtje te rruges, ne vecanti te rruges lokale, qe lidh fabriken me qytezen e Repsit e ate nacionale, larje te gomave mjeteve perpara daljes ne kete rruge, per te evituar derdhjen e mineralit apo koncentratit te bakrit.
- Ndjekie te projektit per devijimin e ujrave siperfaqesore qe formohen nga dy perroskat siper objektit gjate rredhjeve, sistemim te tyre me prita malore, orjentim te ujrave ne dy degezime kanali prej betoni, anash venddepozitimit (dampes).

Kjo mase merret per te evituar renien e ujrave te rrembyeshem se bashku me dherat e masivit malor ne vendin e depozitimit, duke parandaluar perhapjen e mases sterile ne mjedisin jashte dampes e ujrat e lumit Fan.

- Zbatim korrekt te projektit teknologjik te pasurimit per te arritur produkt cilesor dhe parametra ligjore ne permbajtjen e elementeve perberes ne ujrat industriale te shkarkimit
- Zbatim korrekt te ndertimit te dampes me te gjithë elementet perforcues argjinature etj, si ndjekie korrekte e rregjimit te punes ne kete venddepozitim
- Permiresim te sistemit te kapjes se pluhurave ne linjat e thyerjes, bluarjes. e sitosjes, si dhe te ventilimit ne mjediset e perdorimit te reagenteve kimike.
- Sistemim e rregullim te mjediseve rreth objektit, mbjellje e pemeve dekorative per te shtuar siperfaqen e gjelberuar ne kete zone.

#### c-Masat estetike dhe ekologjike

Ne kete projekt gjate ndertimit dhe shfrytezimit eshte parashikuar :-

- Ndertimi i gjithë elementeve te kesaj fabrike dhe venddepozitimit ne pershtatje me ketesat bashkekohore per objekte te kesaj natyre.
- Ruajtja e parametrave teknik e teknologjike si dhe hapsirat ndermjet mjediseve te punes, ndricimit optimal, ventilimit etj. per kushte te kornfortit te punes sipas kerkesave ligjore .
- Lyerje te fasadave te ndertesave dhe konstruksioneve metalike perkatese sipas normave te

estetikes per skema te tilla.

- Te behet sistemimi perreth territorit dhe rrethimi se bashku me ndricimin e jashtem e orjentim me sinjalistiken e duhur per hyrje-daljet ne fabrike e vendeponim.
- Krijim i kushteve te pershtatshme per rritjen e siperfaqes se gjelberuar .
- Krijim i kushteve optiinale me ambjentet e nevojshme higjeno-sanitare per personelin, e zbatim te normave per ujrat e shkarkimeve, duke aplikuar grope septike etj, ne konsulence me autoritetet shendetesore te zones.
- Mbajtje nen kontroll te vazhdueshem i ambjetit ne objekt e rreth tij duke e pastruar rregullisht, e sistemuar rast pas rasti ne vartesi te nevojave, per te ruajtur dhe permiresuar elementet estetike e ekologjike te zones.

## 6. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

### 6.1. Te pergjithshme per Bashkine Mirdite

Administrativisht, zona e zhvillimit të projektit gjendet në Njësinë administrative Orosh të Bashkisë Mirditë (sipas ndarjes së re administrative).

Bashkia Mirditë përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Rrësheni, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Mirditës dhe qarkut të Lezhës. Bashkia e re, zë një sipërfaqe prej 869.71 km<sup>2</sup> dhe ka nën administrimin e saj katër qytete (Rrëshen, Rubik, Kurbnesh dhe Rejs) dhe 81 fshatra. Qendra është qyteti i Rrëshenit.

Njësia administrative Orosh zë një sipërfaqe prej 135.1 km<sup>2</sup> dhe pozicionohet në pjesën qendrore – verilindore të bashkisë Mirditë dhe përmbledh fshatrat Peshqesh, Lgjin, Blinisht, Kullaxhi, Kodër Spaç, Mashtëkor, Grykë Orosh, Bulshar, Planetë, Shtrungaj, Guri i Bardhë, Gurth Spaç, Nënshajt, Katund i Ri dhe Lajthizë.

Figura 3.5– Harta administrative e Bashkisë Mirditë



Për shumë shekuj ajo ka qenë kryeqendra e krahinës së Mirditës. Në Orosh u ngrit shumë herët Abacia, e cila varej drejtpërdrejt nga Selia e Shenjtë. Aty ngriheshin dikur dhe sarajet princërore të Gjonmarkajve, të cilët për shkak të zbatimit të kodeve dokësore përbënin shembullin e vetëqeverisjes.

Bashkia Mirditë është një ndër zonat verilindore të vendit të cilat janë të kushtëzuara nga vështirësitë e fenomenet natyrore si relievi, klima, largësia etj. Një mundësi e mirë zhvillimi për këtë zonë u krijua nga ndërtimi i superstradës Milot-Kukës, pjesë e rrugës që lidh portin më të madh në vend, Durrësin me Kosovën.

Një segment i superstradës përshkon tërthorazi territorin e Bashkisë Mirditë në drejtimin jugperëndim-verilindje duke përfshirë edhe Oroshin.